



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

Procesverbal 03/2026

I Mbajtur në takimin e III-rë të rregullt të Kpf-së me datën 26.06.2026, në sallën e e takimeve në ora 10:00 rën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, dhe Zyrtares për informim.

Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;

Përsëritet për të gjithë të pranishmit, drejtor/e, të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të KPF-së. Po fillojmë me mbledhjen e III-rë të rregullt të KPF-së dhe për këtë mbledhje propozoj këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KPF-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KPF-së;
4. Propozim – Vendim për miratimin e kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029
5. Propozim – Vendim për Miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.
6. Të ndryshme.

Kryesuesi i kk-s pasi e lexoi rendin e ditës të lartëcekur theksoi apo pyeti nëse ka dikush rreth rendit të ditës, ku fjalën e morri Vanesa Topojani e cila theksoi që kemi një kërkesë apo një pikë shtesë për rend të ditës është me urgjence pasi punimet që kanë filluar janë me 5 korrik dhe duhet trajtuar menjëherë, bëhet fjalë për organizatën shtëpia ime ku vendimi që është marrë për me ju dhanë në shfrytëzim shtëpia që gjendet në atë parcelë të plotësohet-ndryshohet vendimi duke ju dhanë në shfrytëzim komplet parcelën në fjalë, Ejup Delolli sa për skjarim në mandatin e kaluar në zaskok ku është kan zyra vendit atë objekt ja kemi dhanë në shfrytëzim kësaj organizatës në fjalë, dhe ata kanë gjetë donatorë për me zgjeruar atë objekt, mirpo në kuvend e bajm gati me të gjitha gjanat qysh shkon.

Dhe të gjithë pajtohen që të përgaditet si pikë e rregullt për në Kuvend.

Kryesuesi i kk-s thekson që dëshiroj ta diskutojmë këtu edhe një qështje ju e dini që ka qenë 2 herë në kpf qështja e objektit të dakonit e dini që u diskutu disa herë është një kërkesë që ka ardhë prap dhe ju e

dini që komuna ka marrë një hapsirë për nënkalim dhe ata kan kërku që si formë e kompenzimit të jetë lejmi i objektit 3 kat plus që realisht e ka ndërtu, nëse jeni të pajtimit që ta qesim në kuvend e qesim nëse sjeni të pajtimit se qesim pasi është hera e tretë që po del ne kuvend ajo pikë nëse dmth e qesim edhe njëher.

Brahim Osmani thekson që sa i përket kësaj pike ju e dini që aj objekt veq ka fillu mi ndërtu dhe nëse është pa leja duhet drejtorit me na njoftu qysh ka vazhdu sa ka marrë vendim.

E dyta kuvendi ska të drejtë pasi veq prsihtina e ka koeficientin për bonuse dhe ne si grup jemi kundër edhe tash u ndërtu ajo mirpo tash me marr vendim ndërto kur ajo u kry, me pas prokuroi sot ndrysh ish disku kjo çunë po meqenëse so tu funksionu ne jemi kundër edhe këtu edhe ne seance do te jemi kundër.

Visar Azemi thekson që për besë ne duhet me rrzu atë objekt e mja nis prej fillimit kshtu që ma mirë është ndoshta ma mirë është mu drejtu në forma të legalizimit kshtu neve po na bjen me votu diqka të kundërligjshme diqka që ka ndodhë.

Kryesuesi propozon që të diskutohet në një mbledhje tjerër pasi edhe kërkesa ka ardhë me vonesë.

Kryesuesi e qet në votim rendin e ditës me pikën shtesë që u propozu nga Vanesa dhe kaloi me 8 vota per 00.

Kryesuesi pyet nëse keni vrejtje për procesverbal dhe pasi spati kaloi me 8 vota për 00.

Rreth kornizës afatmesme buxhetore Sebahate Ajeti Sadiku pasi përshëndeti të pranishmit thekson që veq dashta sa për info në parim buxheti ka rritje për afër 3 milion kjo rritje ka afektu te granti përgjithshëm kshtu që nga të hyrat nëse i inklasojmë ku nga granti i përgjithshëm 1 milion për paga dhe pjesa tjetër është për projekte dhe vlen me theksu që projekte të reja nuk ka.

Visar Azemi unë fillimisht kërkoj fjale pasi është hera e parë që ballafaqohem me këto, dmth kur flasim për parqe të reja apo Ferizaj i ri apo projekte te reja në Ferizaj, a i dim këto lokacione pasi me i qit 40 projekte ne listë pom doket si shumë, qysh shkojn këto ku kan mu vendos për qfar hapsira po falsim, Kryesuesi thekson që ky është parashikimi pak ma afatgjatë me prioritete që mund të ndryshojnë e që konkretizohen në buxhet.

Arian Imeri një prej arsyeve është kemi pas raste kur i kemi detaizu projektet që kanë pas me ndodhë, psh projektin te parku i qytetit te shkolla gjon sereqi dhe qeveria i ka ndryshu psh.

Nëse ska tjera a jeni që të kaloj në kuvend dhe u votua me 6 vota për 00.

Kryesuesi e lexon pikën e 5 dhe fjalën ia kalon drejtorit të shërbimeve publike Alberton Sahiti i cili pasi përshëndeti të pranishmit thekson që kjo pikë i ka kaluar të gjitha fazat dhe është një fat i mirë që po bëhet kjo, është ba prej gazit gjerman u financu prej ba prej bankës europiane të investimeve dhe nëse gjene mbështetje prej donatorve të jashtëm për investim është një plan për komuën 05-06 pasi do të bëhet një zgjidhje përfekte për mbeturinave pasi që 25 vite pas luftës flasim për ndarje të mbeturinave mirpo tash ne këtë plan është një vullnet i qeverisë e komunave për ta rregulluar këtë qështje, kushdo që ka diqka jam këtu me skjaru.

Yllka Neziri Hyseni pasi përshëndeti të pranishmit thekson që deshta me ta ba një pyetje te pika e transferit në gerlice a është mbyllë përgjithmone apo përkohësisht.

Drjetori thekson që kjo pikë ka kërku nga ministria që të mbyllet dhe do ta sjellim në kuvend dhe do ta bëjmë një pikë të re pasi e dim që ka shpenzime shumë për ti grumbulluar pasi është qendër transferit ti e din që je pjesë e komnaisë.

Visar Azemi drejtor dhe ju të gjithë besoj që të gjithë pajtohem që një prej sfidave ka qenë bërllogu dhe përtej dallimeve politike, donatort gizin e kemi një prej partnerve që kan edhe eksperienc, të marrim pak me seriozisht këtë qështje unë propozoj që të kemi edhe te forma e sanksionimit më shumë seriozitet, prandaj është mirë me kërku mbështje edhe në kuvend edhe tek inistucionet që ta miratojmë këtë dhe ta tejkalojmë këtë sfidë që përballen qytetart.

Kryesuesi pyeti nëse ka tjerë për diskutim dhe pasi spati e hodhi në votim dhe kaloi me 8 vota për 00.

Në të ndryshme e kemi pikën shtesë për lejmin e zgjerimit të objektit dhe shfrytëzimin e parcelës, pasi u hodh në votim kaloi me 8 vota për 00.

Kryesuesi e shpalli të mbyllur këtë mbledhje.

PROCESMBANTËSI:
LEUTRIM MAHMUTI



KRYESUESI I KK-së
XHAVIT ZARIQI

